



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 29.12.2014, në orën 13:25

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku dhe Milena Miliqeviq.

Munguan: Melihate Termkolli dhe Jakup Krasniqi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Nuk kishe pjesëmarrës tjerë

Nga Staf i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;

Kryetarja paraqiti vërejtje në Projektligjin për Buxhetin veçmas tek fondi për veriun i cili nuk është në pajtim me ligjin për Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, sepse ndanë sistemin financiar të shtetit. Vërejtje paraqiti edhe tek neni 9 paragrafi 3 ku kërkohet që të gjitha mjetet e grumbulluara të pasqyrohen në tabelat buxhetore duke përfshirë këtu edhe mjetet e grumbulluara në pikat doganore në Veri të Kosovës mirëpo që të pjesa tabelore nuk ka asnjë informatë për shumat që pritet të derdhen në këtë fond gjatë këtij viti dhe ato të vitit paraprak.

Po ashtu vërejtje kishe edhe lidhur me shkurtimet buxhetore për institucionet e drejtësisë që sipas saj as 2% e buxhetit të shtetit nuk shkon për këto institucione që është për keqardhje duke pas parasysh gjendjen që ka sistemi i Drejtësisë. E njëjta nuk ka ndodhë edhe me ministrin e Kthimit, e cila ka ngritje të buxhetit me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional. Vërejtje kishe edhe në amendamentin 2 të Komisionit funksional lidhur me financimin e RTK-së lidhur me mënyrën e financimit pa ndonjë plan financiarë duke e konsideruar si një organizatë buxhetore. Në fund tha se është përgjegjësi e Komisionit për Legjislacion, jo në këtë fazë pasi jemi para aktit të kryer, por me rastin e rishikimit të buxhetit duhet të insistojmë që të plotësohen nevojat për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorin e Shtetit.

Danush Ademi, tha se ne kemi kërkuar ndarjen e një kodi të veçantë buxhetor në ministrin e kthimit në mënyrë që edhe komuniteti jonë ta shfrytëzoj këtë buxhet. Kam pasur informacione që Komisioni për buxhet është pajtuar me kërkesën tonë por nuk po e shoh që është përfshi në raportin e komisionit për buxhet dhe financa nuk e di për çfarë arsye.

Armend Zemaj, tha se tani në raportin e komisionit për buxhet dhe financa janë përfshi edhe amendamentet që kemi propozuar, pavarësisht asaj që nuk e kanë përkrahjen e Komisionit funksional. Për hir të korrektësisë po sqaroj se ajo çka kemi kërkuar me këtë amendament është zbatimi i ligjit i cili është miratuar vitin e kaluar e që nuk janë përfshirë edhe pensionistet kontribut dhënës për vitet 1989-1999, punëtorët e arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerët që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës. Ai shtoi se kjo është fatkeqësi se si kjo kategori që kanë punuar para lufte disa vite ajo pjesë mos të ju njihet në stazh duke i pamundësuar kështu që mos e gëzojnë pensionin kontribut dhënës duke ju llogaritur vetëm përvojën pas luftës.

Doruntinë Maloku, lidhur me amendamentin e 2 të Komisionit funksional që ka të bëjë me financimin e RTK-së tha se prej periudhës maj deri në muajin dhjetor 2015 RTK-ja duhet të gjejë një zgjidhje për parapagim. Ishte e mendimit që tek amendamenti 2 ku thuhet se “RTK-së i ndahen 0.7 % “ të ceket që kjo nuk mund të jetë në buxhetin e vitit të ardhshëm 2016 .

Selvije Halimi, tha se fushëveprim i komisionit tonë në këtë fazë është që të shqyrtojmë vetëm aspektin e pajtueshmërisë së Projektligjit me Kushtetutën dhe ligjet tjera. Kurse lidhur me ndarjen e fondit për veriun dha se kjo është bërë në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ku ndahet si një nënkodi por që kalon përmes buxhetit të Kosovës. Ajo duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetit Zemaj lidhur me atë që nuk janë përfshirë edhe pensionistet kontribut dhënës për vitet 1989-1999 tha se ka marrë pjesë në hartim kur është punuar Projektligji dhe ishte kërkuar nga Ministria e financave të rishikohet për shkak të implikimeve buxhetore që ka pas dhe ka qenë një pëlqim i ministrisë që të rishikohet edhe një herë para se të vij në Kuvend.

Lidhur me procedimin e raportit me amendamente në Kuvend, Komisioni ishte i ndarë, ku për procedimin e raportit në Kuvend votuan: Selviqe Halimi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Danush Ademi dhe Agim Ademaj, kurse abstenuan: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Doruntina Maloku dhe Milena Miliqeviq.

Pas diskutimeve, Komisioni me 5 vota “për” dhe 4 “abstenime” nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t’i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Të ndryshme.

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Albulena Haxhiu